



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. ____ Prot

Prrenjas më: ____ . ____ .2024

P /VENDIM

NR. ____ DATË ____ . ____ .2024

PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.05 DATË 27.12.2023 TË KËSHILLIT BASHKIAK PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE DHE SHPËRBLIMEVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE
TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR PËR VITIN 2024

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54 pika ç, Ligji nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave ,trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e Administratës Publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", VKM nr.503 datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.328,datë 31.05.2023,të këshillit të ministrave për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____ . ____ .2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke filluar nga data 01.09.2024
2. Shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë Prrenjas.
3. Shpërblimin e kryetarëve të fshatrave në masën deri në 10% të pagës së Administratorit të Njësive Administrative përkatëse.
4. Miratimi i nivelit të pagave sipas tabelës bashkëngjitur.
5. Ngarkohen për zbatim e vendimit: Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më ____ . ____ .2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ Datë _____

"Mbi dhënie e ndihmës ekonomike me 6% të fondit të kushtëzuar të bllok ndihmës ekonomike muaji SHTATOR 2024".

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57, datë 18.07.2019 ' Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë', bazuar gjithashtu në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i azhornuar me ligjin nr.10399 datë 17.03.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin në.9355 datë 10.03.2005 " Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar në nenin 7, në VKM nr.787 datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", si dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, administratorja e zyrës së ndihmës ekonomike i propozon Këshillit të Bashkisë, të trajtohen me ndihmë ekonomike me kriter të veçantë:

1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,
2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale,
3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune,
4. Familje me shumë fëmijë
5. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin universitetin,
6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/invalidë pune

I propozoj Këshillit të Bashkisë të trajtohen nga fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike për muajin SHTATOR , 45 familje me fond 242.838 LEKË.

Bashkëngjitur është lista e familjeve.

Përgjegjës i Shërbimit Social

Kryetari i Bashkisë

Besim HANA

Nuri BELBA